

UDHËTIMET E ÇAJLD HAROLDIT- George Gordon Byron

Byron e përfundon veprën në 1818, në Epokën e Restaurimit. Ai nuk do vendosjen e mbretërive, por lirinë e popujve të shtypur.

Është një poemë epiko-lirike, që përbëhet nga 500 strofa dhe ndahet në 4 pjesë (këngë).

KËNGA I

Portugali- dhimbje, melankoli, zhgënjim, pakënaqësi shpirtërore, që vijnë përmes lirismit të thellë, p.sh. “Kënga e lamtumirës”.

Spanjë- lufta kundër Napoleonit, trimëritë e spanjollve, zhgënjimi nga fitorja e aristokracisë, kontrast dhe doza të vogla hiperbolizimi.

KËNGA II

Greqia- natyra në kontrast me fatin e popullit grek, kujton monumentet e lashta dhe realitetin e zymtë.

Shqipëria- 360 vargje, njohës i mirë i historisë, vëzhgues i mprehtë i realitetit.

- Mahnitet nga bukuritë e natyrës dhe ashpërsia e tyre
- Nxjerr në pah karakterin bujar, trim, mikpritës të shqiptarëve
- Pikas autoritetin sovran të Ali Pashait të Tepelenës
- Admirim për të kaluarën e lavdishme, historinë
- Vlerësim në aspektin moral e kulturor
- Apostrofime të fuqishme të natyrës
- Vargje plot lirisëm, entuziazëm, gjallëri
- Dhuntitë morale të gruas, por edhe shtypja
- Pasuria etnografike (veshjet, dhomat), këngët polifonike, vallet

Arti i Byron:

-Çlirohet nga rregullat e ngurta të klasicizmit

-U krijua heroi baronian: individualist, i pakënaqur, i vetmuar

-Shumë figura dhe qëndrim emocional

-Haroldi nuk vepron, kurse Byron po

Të rreptë bijt' e shqipes! Po vetitë
nuk u mungojnë; veç t'ishin më të arrira;
armiku ua pa kurrizin ndonjëherë?
Kush e duron si ata mundimn' e luftës?
Shkëmbinjt' e tyre s' janë më të patundur
nga ata në çast rreziku dhe nevoje:
Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!
Kur besa a nderi i thrret të derdhin gjakun,
Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre.

KOMENT

Pasi Byron ka recituar historinë e lavdishme të shqiptarëve dhe natyrën e virgjër të Shqipërisë, që është një karakteristikë e poetëve romantikë, në këtë strofë, ai himnizon virtytet shqiptare: trimërinë dhe besën. Që në vargun e parë, autori vjen me një thirrje. Ai ka përdorur inversionin dhe ka vendosur pikëçuditëse, për ta bërë më emocionale dhe dhe për të na përcjellë ndjenja sipas stilit të tij romantik.

E ndërsa thotë se shqiptarët janë të rreptë, madje e përsërit për ta theksuar, nga ana tjetër ai përdor lidhëzën kundërshtuese 'por', për të na bërë të kuptojmë se pavarësisht një egërsie kaq të madhe, ata janë njerëz me vlera. Më tej, ai kundërshton në mënyrë më të zbutur me lidhëzën 'veç' vetitë e këtyre njerëzve. Me anë të kësaj, Byron vë në dukje paragjykimet patriarkale, në lidhje me rolin e gruas në shoqëri.

Në dy vargjet vijuese, poeti ka përdorur dy pyetje retorike për të krijuar një efekt tingëllor e ndjesor, që ndërthuret mjaft mirë, qoftë me të shprehurit lirik, po ashtu dhe me atë epik, karakteristikë e poemave epiko-lirike, siç është poema në fjalë. Ne kuptojmë nga këto vargje se shqiptarët janë të zotët, të duruar, të papërulur.

Në vazhdim, Byroni bënë unifikimin e njeriut me natyrën. Për të shqiptarët janë aq të fortë e të patundur, sa ia kalojnë edhe shkëmbinjve, të cilët barazohen me fortësi me njerëzit në rast rreziku. Pra, natyra i vjen në ndihmë njeriut. Këtu, Byron i frymëzuar prej natyrës, na vjen me një pikëpamje tipike romantike.

Më poshtë, vargjet flasin për një karakter burror, që gjendet veçanërisht te njerëzit e paprekur nga veset e qytetërimit. Autori i sheh shqiptarët sa të ashpër janë me armiqtë dhe njëkohësisht sa besnikë me njerëzit e tjerë dhe e ndërton këtë varg mbi bazën e antonimisë. Ai na i sjell shqiptarët si njerëz, që rebelohen dhe nuk e durojnë dot zgjedhën e pushtuesve. Ata janë njerëz të udhëhequr dhe këtë autori e ka shprehur edhe në strofën e parë dhe

gjithashtu janë të gatshëm të sakrifikohen në emër të gjërave më të shtrenjta e të rëndësishme, që janë nderi dhe besa.

Pra, kjo strofë është një strofë tipike romantike, ku autori shpreh dashurinë për lirinë, përcjell ndjenja, frymëzohet nga natyra dhe shpreh me pasion pakënaqësinë dhe rebelimin e shqiptarëve.